



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:291963

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05732656

P.nr.875/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Qendresa Tahiri- Islami, në çështjen penale kundër të pandehurit: B.F, për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.2127/2021 e datës 24.12.2021, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit; ND.663/2024, të datës 03.04.2024, të lidhur në mes të pandehurit: B.F dhe të dëmtuarit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, jashtë seancës e në mbështetje të nenit 357 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPK) dhe nenit 2 par. 2, nenit 8, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me datë 24.05.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit; ND.663/2024, e datës 03.04.2024, e lidhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në mes palëve, të pandehurit: B.F, dhe të dëmtuarit: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.2127/2021 e datës 24.12.2021, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit:

B.F, nga i ati, e ëma, i lindur me datë, në fshatin Vaganicë, komuna e Mitrovicës, ku edhe jeton, me numër personal, i martuar, baba i tre fëmijëve, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.2127/2021 e datës 24.12.2021, kundër të pandehurit: B.F, për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata, me datë 12.03.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë i pandehuri B.F ka propozuar që kjo çështje të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe Prokurori i shtetit, kanë deklaruar se pajtohen që kjo çështje të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit.

Pas dhënies së pëlqimit nga ana e palëve në procedurë, lidhur me referimin e kësaj lënde në procedurë të ndërmjetësimit, Gjykata konform dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërmjetësim, këtë çështje penale e referoi në procedurë të Ndërmjetësimit.

Me datën 03.04.2024, në Zyrën e Ndërmjetësimit pranë Gjykatën Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj është arritur Marrëveshja e Ndërmjetësimit me numër ND.663/2024, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit: të pandehurit: B.F, dhe të dëmtuarit: Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, të cilën marrëveshje gjykata e ka pranuar.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 2 par.2, dhe nenit 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata, pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale është arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, sipas Ligjit për Ndërmjetësim, dhe aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës duke u mbështetur në nenin 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, Gjykata konstaton se kjo është një rrethanë e cila e pengon ndjekjen e mëtejme penale dhe mbi bazën e këtyre arsyeve e duke u bazuar në nenin 357 par. 1 nën par.1.3 të KPPK-së, vendosi që të hedhë akuzën dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit.

Konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim në datën e aprovimit të kësaj marrëveshje nga gjykata, përkatësisht nga data 03.04.2024, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 par.1 të KPPK-së, pasi që është pushuar procedura penale, ndërsa i pandehuri i ka paguar vetë shpenzimet e ndërmjetësimit në atë procedurë.

Nga sa u tha më lartë dhe konform nenit 357 par. 1 nën par.1.3 të KPPK-së, e lidhur me nenin 2 dhe nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.875/2021, datë 24.05.2024

G j y q t a r e:
Qendresa Tahiri- Islami

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit.